



Planuar / Dërguar Prilbena/Prodato Received/Delivered	15 - 02 - 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	1818/2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.1252/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1252/2022 të datës 23.12.2022, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/ Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.02.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1252/2022 e datës 23.12.2022, e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Prizrenit, sipas Akt emërimit të datës 02.06.2015 në pozitën *Zyrtar i lartë për energjetikë* në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Me datën 01.09.2022 Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.01-133859 sipas se cilit ankuesi nga pozita *Zyrtar i lartë për energjetikë* në Drejtorinë e shërbimeve publike, është caktuar si zëvendësues në pozitën si Udhëheqës i Sektorit të IT-së në Drejtorinë për Administratë të Komunës së Prizrenit.

Ankuesi me datën 28.10.2022, ka parashtruar kërkesën me numër 01030 Nr.154041 tek Njësia e burimeve njerëzore të Komunës së Prizrenit lidhur me kompensimin e pagës për të cilën është caktuar zëvendësues së bashku me komponentët tjera (shtesat) të parapara sipas akteve ligjore në fuqi.



I pakënaqur me mos veprimin e Njesisë së burimeve njerëzore të komunës së Prizrenit kundrejt kërkesës së parashtruar me datën 28.10.2022, ankuesi me datën 23.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8396/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të aplikimit të gabuar të Ligjit për Zyrtar Publik dhe shkeljeve të procedurës administrative për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit ndaj kërkesave të vazhdueshme të ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit me datën 01.02.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesën e ankuesit së bashku me shkresat lidhur me këtë çështje.

Me datën 02.02.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit Gëzim Gërgi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendosjes meritore në lidhje me këtë ankesë, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 8396/2022 të datës 23.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01-133859 të datës 01.09.2022 të Udhëheqësit të burimeve njerëzore të komunës së Prizrenit; Kërkesën me numër 01030 Nr.154041 të datës 28.10.2022 të parashtruar nga ankuesi tek komuna e Prizrenit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.02.2023 nga komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 02.06.2015; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 28.10.2022 me numër 01-030/01-0154041/22 të parashtruar nga ankuesi tek komuna e Prizrenit; E-mailin zyrtar të datës 27.10.2022 lidhur me opinionin ligjor; Kërkesën për sqarim të parashtruar nga ankuesi tek Drejtoresha e DMZP-së; Opinionin ligjor me numër Nr.3316 të datës 05.11.2019 nga MAP; Listën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 për ankuesin; Vendimin me numër VK/2023 të datës 02.02.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës; Kërkesën për prova shtesë me numër protokollit 1739/2023 të datës 14.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e pagave për muajt qershor, korrik dhe gusht të vitit 2022 për ankuesin; Diplomën e ankuesit me numër Nr.112 të datës 07.01.1991 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Elektroteknik i Prishtinës së bashku me shtojcën e diplomës me numër Nr.3479/13 të datës 05.12.2003; Akt emërimit të ankuesit të datës 01.01.2012; Kontratën e punës së ankuesit me numër Nr.01-112-244 të datës 01.01.2005 dhe Vendimin me numër Nr:01-133859/01 të datës 21.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: "përveç kur përjashtohet



*shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik'' ,përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon se një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtje administrative) i organit përkatës të punësimit i cenon një të drejtë të përcaktuar me ligj, ka të drejtë të parashtoj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 98 me të cilin është përcaktuar se: *"1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj..."*, si dhe nenit 127 paragrafi 4 me të cilin parashihet se: *"... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muajt pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datën 23.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundrejt mosveprimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit lidhur me kërkesën me numër 01030 Nr.154041 të datës 28.10.2022 të parashtruar nga ana e ankuesit, është brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës lidhur me çështjen e ankuesit, ka konstatuar se ankuesi me datën 01.09.2022 përmes Vendimit me numër Nr.01-133859 i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, është transferuar për të zëvendësuar përkohësisht pozitën e *Udhëheqësit të sektorit të IT-së* në Drejtorinë e Administratës.

Ndërlidhur me rastin e ankuesit si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të tij lidhur me kompensimin e pagës dhe kompensimeve tjera (shitesat) sipas akteve ligjore në fuqi, mbi bazën e të cilave edhe ka parashtruar ankesën në Këshill, Kolegji pasi ka analizuar Vendimin me numër Nr.01-133859 të datës 01.09.2022 i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, ka konstatuar se i njëjti është shfuqizuar me datën 21.12.2022 sipas Vendimit me numër Nr.01-133859/01. Si rrjedhojë ndërlidhur me çështjen në fjalë, Kolegji pasa analizimit të dispozitave të nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë në të cilin është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe dispozitat e nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili ka përcaktuar se: *"Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë"* Ligj ky që ka qenë në fuqi në kohën kur ankuesi është caktuar për të zëvendësuar përkohësisht pozitën e *Udhëheqësit të sektorit të IT-së* në Drejtorinë e Administratës, ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit lidhur me kompensimin e pagës për pozitën të cilën është caktuar si zëvendësues, i njëjti del se sipas Akt emërimit të datës 02.06.2015 për pozitën të cilën e ka mbajtur si Zyrtar i lartë për energjetikë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike pranë kësaj komune, ka mbajtur koeficientin shtatë pikë pesë (7.5) ndërsa sipas listës së pagave për muajt qershor, korrik dhe gusht të vitit 2022 është paguar sipas koeficientit tetë (8), ndërsa sipas listës së pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 të



siguruara nga ana e organit të punësimit lidhur me rastin e ankuesit, i njëjti del se është paguar në vlerën e kompensimit prej nëntëdhjetë eurove (90) për tre muaj sa ka mbajtur këtë pozitë lidhur me ndryshimin e koeficientit nga pozita të cilën e ka mbajtur si Zyrtar i lartë për energjetikë në atë të Udhëheqësit të sektorit të IT-së dhe realisht është paguar sipas vlerës së koeficientit prej tetë pikë pesë (8.5), e krejt kjo edhe në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë...", andaj sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit ankuesit në këtë rast nuk i është cenuar e drejta e kompensimit, siç pretendon me ankesën e parashtruar në Këshill dhe në këtë kontekst edhe pretendimi ankimor i të njëjtit lidhur me kompensimin e ndryshimit të vlerës së koeficientit është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili kërkon kompensimin e shtesave sipas pozitës të cilën e ka mbajtur si Udhëheqës i sektorit të IT-së, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se meqenëse ankuesi me ankesën e parashtruar në Këshill nuk ka precizuar saktësisht se cilat shtesa i kërkon, i njëjti nuk ka mundur të shqyrtoj këtë pretendim të tij për faktin se si i tillë është i pa qartë në kontekstin e precizimit lidhur me realizimin e një të drejte.

Andaj pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1252/2022, 15/02/2023

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare Lartë për Bashkëpunim Profesionale



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

